



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:153340

Datë: 05.08.2020

Numri i dokumentit: 01051325

C.nr.834/19

GJYKATA THEMELORE NE PEJE, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Afërdita Mulhaxha,, në çështjen juridike kontestimore të paditëses N Q, nga Peja, të cilën e përfaqëson Hamijeta Myftari, avokate në Pejë, kundër të paditurës Komuna e Pejës-DKA në Pejë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Fisnik Imami, nga Peja, me bazë juridike kompensim i pagave për përcjellje në pension, vlera e kontestit 1.341,06€, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësorë me dt.29.07.2020, në prezencë të aut. të palëve ndërgjyqëse, pas së cilës me dt.04.08.2020, bie këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET kërkesëpadia e paditëses N Q, nga Peja.

DETYROHET e paditura Komuna e Pejës-DKA, në Pejë, që paditëses N Q, nga Peja, në emër të kompensimit të tri(3)pagave përcjellëse t'ia paguaj shumën totale prej 1.341,06€, me kamatë në lartësi prej 8%, nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit, me dt.04.08.2020, e deri në pagesë definitive, e të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga plotfuqishmëria e aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

DETYROHET e paditura Komuna e Pejës-DKA, në Pejë, që paditëses t'ia kompensojë shpenzimet procedurale në shumën prej 269€, në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

A r s y e t i m

Paditësja në këtë gjykatë nëpërmjet të autorizuarës së saj, me dt.16.07.2019, ka parashtruar padi, me bazë juridike kompensim i pagave në përcjellje në pension, dhe gjatë shqyrtimit kryesor dhe fjalës përfundimtare ka kërkuar kompensimin në emër të shpërbllimit të lartcekur, ka sqaruar se paditësja ka qenë e punësuar në Shkollën Fillore „...”, në Pejë, si mësueses duke filluar nga viti 1989, e deri në pensionim me dt.14.10.2016, për 35 vite e 9 muaj e 16 ditë, përvojë pune, ashtu që ka kërkuar që t'i bëhet kompensimi i tri pagave përcjellëse në shumën totale prej 1.341,06€, të gjitha këto në mbështetje të kontratës së përgjithshme kolektive, që ka hy në fuqi me dt.01.01.2015.Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë: për përpilim të padisë shumën prej104€, për taksë gjyqësore shumën prej 30€ dhe për një përfaqësim, shumën prej 135€, dhe me kamat.

E paditura në afatin ligjor ka parashtruar përgjigje në padi, me të cilën e ka kundërshtuar padinë dhe kërkesën e saj, duke potencuar se është pa mbështetje ligjore, juridike dhe faktike, dhe se nuk përmban prova të pretendimeve faktike, ndërsa në seancën e shqyrtimit gjyqësorë dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë përgjigjes në padi, me arsyetim se paditësja duhet t'i drejtohet Ministrisë së Arsimit, si garantuese e përmbushjes së obligimeve financiare lidhur me të drejtat që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e dt.18.04.2017, për punëtorët e arsimit para universitar, të cilën e ka nënshkruar MASHT-i dhe

SBASHK-u, ku sipas nenit 46 par 2 të Kontratës Kolektive përcaktohet se MASHT-i dhe SBASHK-u, angazhohen bashkërisht në Ministrinë e Financave, për sigurimin e ndarjes së mjeteve financiare për komuna, ashtu që çdo shpërblim në rast të pensionimit, nuk është obligim i të paditurës por i MASH –it dhe Ministrisë së Financave, ka kërkuar refuzimin në tërësi si të pabazuar të padisë dhe kërkesëpadi së saj, duke kërkuar shpenzimet e procedurës dhe ate për përgjigje në padi shumën prej 104€ dhe për një seancë të mbajtur shumën prej 135€.

Gjykata për vërtetimin e plote të gjendjes faktike në këtë çështje juridike–kontestimore, zhvilloj procedurën e provave, ku u administrua si provë: historiat i llogarisë bankare i dt.15.07.2019, dëftesa për pranimin e dërgesës e dt.24.06.2019; kërkesa për kompensim të tri pagave e dt.24.06.2019, vërtetimi nga DKA i dt.13.10.2016; vendimi për njohjen e pensionit i dt.25.10.2016; aktvendimi mbi ndërprerjen e M.P. sipas fuqish ligjore e dt.27.09.2016, librezja e punës në origjinal e cila është krahasuar me fotokopjen dhe origjinali [i është kthyer pas palës paditëse. si dhe deklarimet e të aut. të palëve ndërgjyqëse.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç, dhe të gjitha së bashku e në lidhmëni njëra me tjetrën, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv, të këtij aktgjykimi, për faktin se:

-është vërtetuar se në mes të palëve ndërgjyqëse nuk është kontestues fakti se paditësja N Q, ka qenë e punësuar në vendin e punës mësimdhënëse në Shkollën Fillor të Mesme të Ulët „...”, në Pejë, derisa i është ndërprerë marrëdhënia e punës me dt.02.10.2016, për shkak të mbushjes së moshës mandatorë të pensionit 65vjet, ashtu që me vendimin e datës 25.10.2016, të lëshuar nga Qeveria e Kosovës gjegjësisht nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Pensioneve i është njohur e drejta në pension bazik.

Nuk është kontestues as fakti se pas arritjes së moshës së pensionimit paditësja me dt.24.06.2019, i është drejtuar me kërkesë Drejtorisë Komunale të Arsimit, duke kërkuar rimbursim për tri paga përcjellëse pas pensionimit, mirëpo nga ana e Drejtorisë Komunale të Arsimit, nuk ka marrë përgjigje në këtë kërkesë.

Gjykata duke i vlerësuar provat një nga një dhe të gjitha së bashku erdhi në përfundim se kërkesëpadija e paditëses është e bazuar.

Themelësia e aprovimit të kërkesëpadi së në aspektin ligjor buron nga Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e cila është nënshkruar me dt.18.03.2014, nga Qeveria e Kosovës, Organizata e Punëdhënësve (*Oda Ekonomike e Kosovës dhe Aleanca Kosovare e Biznesit*) dhe Organizata e të Punësuarve (*Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës*) dhe e cila ka hyrë në fuqi me dt. 01.01.2015.

Me nenin 2 të kësaj Marrëveshjeje, është përcaktuar qartë se kush përfiton nga kjo marrëveshje e në rastin konkret paditësja ka shfrytëzuar këtë të drejtë, duke parashtruar padi, ashtu që me rastin e daljes së saj në pension, kjo marrëveshje ka qenë në fuqi, duke marrë parasysh faktin se e njëjta ka dal në pension me dt.02.10.2016, ndërsa marrëveshja e përgjithshme ka qenë në fuqi nga dt.01.01.2015.

Kurse neni 53 i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, ka përcaktuar se „I punësuar, me rastin e pensionimit, gëzon të drejtën në pagesën përcjellëse në lartësi prej tri (3) paga mujore, që i ka marr për tre (3) muajt te fundit”, e në rastin konkret gjykata lartësinë e kërkesëpadi së e ka provuar nga historiat i llogarisë i lëshuar me dt.15.07.2019, nga Banka Ekonomike e Kosovës, në të cilën vërtetohet se tri pagat e fundit të paditëses për muajin korrik, gusht dhe shtator, të gjitha ishin në shumën prej 447,02€, që e bëjnë shumën e gjithmbarshme 1.341,06€.

Gjykata nuk pajtohet me pretendimin e palës së paditur që garantuese e përmbushjes së obligimeve financiare nga kërkesëpadija e paditëses është Ministria e Arsimit dhe Ministria e Financave, lidhur me të drejtat e të punësuarve në sektorin e arsimit para universitar që rrjedhin nga Kontrata Kolektive, sepse në Ligjin për Arsim në Komunitet e Republikës së Kosovës Nr.03/L-068 të datës 2008, në Kreun II (*Përgjegjësitë dhe Kompetencat e zgjeruara të*

Komunave) gjegjësisht nenin 4 (kompetencat dhe kompetencat e Zgjeruara të Komunave) par 1 përcaktohet që „komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive për aq sa ato i takojnë interesit lokal, ndërkohë që respekton standardet e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi në lidhje me dispozitat e arsimit publik, parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve arsimore, marrjen në punë, pagesën e rrogave dhe aftësimin e mësimdhënësve dhe administratorëve”, dhe në nenin 16 dhe 17 paragrafi h të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale përcaktohet që „komunat kanë kompetencat të plota dhe ekskluzive, për sa i përket interesit lokal, duke i respektuar standardet e përcaktuar në legjislacionin e zbatueshëm, në fushën e përcaktuar nën pikën h“, ofrimin e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve edukative, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e instruktorëve dhe administratorëve të arsimit, e duke u mbështetur në të lartcekurat obligimi bie mbi Komunën e Pejës, që të bëjë realizimin e kërkesave të paditëses, duke pas legjitimitet real pasiv për këtë çështje juridike kontestimore.

Vendimin mbi kamatën gjykata e ka bazuar në nenin 382 të Ligjit për Marrëdhënie të Detyrimeve Nr.04/L-077, duke vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi sa i përket shpenzimeve të procedurës konform dispozitave të nenit 452 paragrafi 1 dhe nenit 463 par 1 të LPK-së, duke e detyruar të paditurën që paditëses t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës dhe atë për: për përpilim të padisë shumë prej 104€, për përfaqësim në një seancë gjyqësore shumë prej 135€, për taksë gjyqësore shumë prej 30€, gjithsejtë shumë prej 269€, shpenzime këto të parapara sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës, e të cilat janë specifikuar edhe në seancës e dt.29.07.2020.

Andaj nga të lartcekurat më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

NGA GJYKATA THEMELORE NË PEJË, C.nr.834/19, me dt.04.08.2020

Gj y q t a r j a
Afërdita Mulhaxha

KËSHILLË JURIDIKE:

*Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa,
në afat prej 7 ditësh, pas marrjes së këtij aktgjykimi,
drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.*